



MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZË STATISTIKORE
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore

GUSHT 2021

Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	2
Kreu 1: Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore.....	6
1.1 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridik parësore.....	10
1.2 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.....	11
1.3 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	16
1.4 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010.....	18
1.5 Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	20
Kreu 2: Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike dytësore.....	25
2.1 Të dhëna statistikore sipas kategorisë përfituese femra dhe meshkuj.....	25
2.2 Të dhëna statistikore sipas kategorisë përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ose kategori e veçantë sipas ligjit.....	25
2.3 Të dhëna statistikore sipas llojit të ndihmës dytësore të ofruar.....	26
2.4 Të dhëna statistikore sipas vendimit të Gjykatës apo organit procedues.....	27
2.5. Të dhëna statistikore sipas llojit të çështjes	28
2.6. Të dhëna staistikore sipas Gjykatave që kanë dhënë vendimet.....	29
2.7 Të dhëna statistikore mbi totalin e rasteve të raportuara me objekt ndihmë juridike dytësore/përgjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore...29	
Konkluzione	31
SHTOJCË: Ndhima juridike parësore/dytësore Janar – Gusht 2021	33

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e *cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.*

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;

- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave/ave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat

KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

1.1 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: *Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.


Aktualisht, gjatë periudhës Gusht 2021, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si vijon:

- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Gjirokastër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).

Për muajin Gusht janë administruar 201 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore


Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Vikti ma Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Tiranë	32	-	32	15	17	32	-	5	7	20	18	4	10	-	-
Lezhë	18	-	18	7	11	18	-	10	8	-	9	2	7	-	-
Durrës	27	-	27	10	17	27	-	25	2	-	11	-	16	2	-
Lushnje	11	-	11	4	7	11	-	7	4	-	10	-	1	2 romë	-
Shkodër	16	-	16	11	5	16	-	15	1	-	15	-	1	-	1
Gjirokastrë	50	-	50	26	24	50	-	31	19	-	20	-	30	2 romë, 2 egjiptianë	3
Pogradec	12	-	12	6	6	12	-	5	7	-	10	-	2	2 romë	-
Fier	21	-	21	10	11	21	-	17	3	1	2	-	19	1	-
Dibër	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlorë	14	-	14	5	9	14	-	9	5	-	9	-	5	3 romë, 2 egjiptianë	-
TOTALI	201	-	201	94	107	201	-	124	56	21	104	6	91	16	4

Rastet për muajin GUSHT /Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore




■ Rastet per muajin Gusht/Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore


Rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas gjinisë



Rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas natyrës së çështjes



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive përfituese të përcaktuara në ligj



- Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme
- Kategori të Veçanta
- Papërcaktuar

1.2 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Moshë		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
“Qendra e Këshillimit për Grat dhe Vajza” ¹	7	0	7	7	0	7	0	0	3	4 (viktima të dhunës në familje)	0	4	3	0
“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	2	0	2	2	0	2	0	0	0	0	2	0	0	2
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	2	0	2	2	0	2	0	0	2	0	0	2	0	0
“Intelektualët e rinj shpresë”	1	0	1	1	0	1	0	0	1	0	0	0	0	1
CRCA	6	6	0	3	3	6	0	0	0	6 (1 i mitur në konflikt me ligjin; 5 viktima të abuzimit seksual)	0	0	6	0
“Forumi i Gruas Elbasan”	3	0	3	3	0	3	0	0	0	3 (viktima të dhunës në familje)	0	3	0	0

¹ 41 raste të trajtuara përmes Linjes Telefonike 116117 këto muaj.


“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	13	13	0	7	6	0	0	13	13	0	0	0	13	
“Të ndryshëm dhe të barabartë” ²	10	2	8	10	0	10	0	0	2	8(3 viktima të trafikimit ose viktima të mundshme të trafikimit dhe 4 viktima të dhunës në familje; 1 viktimë e abuzimit seksual)	0	2	1	7
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	19	0	19	15	4	19	0	0	6	13(11 viktima të dhunës në familje; 1 person me aftësi të kufizuar; 1përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	0	10	3	6
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	12	1	11	5	7	0	12	0	0	0	12	0	0	12
“Qendra Konsumatori Shqiptar”	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
TOTAL³	75	22	53	53	22	50	12	13	27	36	12	23	13	39

Për muajin GUSHT janë administruar 75 raste nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara

² 10 raste te trajtuara permes Linjes Telefonike kete muaj.

³ Në total 7 romë dhe 1 egjiptian të cilëve ju është ofruar ndihmë juridike parësore nga organizatat për muajin Gusht 2021 (1 rast LKGV; 6 raste TLAS dhe 1 rast RMSA).


Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuar




■ Series1

7	2	2	1	6	3	13	10	0	19	12	0
---	---	---	---	---	---	----	----	---	----	----	---


Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes



Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



■ Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ■ Kategori të Veçanta ■ Të paidentifikuar

1.3 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 10 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

- 1.Fakulteti i Drejtësisë;**
- 2. Kolegji Universitar “Wisdom”;**
- 3. Klinika e Ligjit Shkodër (Hapur nga OSFA);**
- 4.Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
- 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
- 6.“Universiteti European i Tiranës”;**
- 7. “Universiteti “Qirjazi”**
- 8. Universiteti “Bedër”**
- 9. Universiteti “Mesdhetar”**
- 10. Universiteti “Marin Barleti”**

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfituar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin GUSHT janë administruar 0 raste⁴ nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Klinikat e ligjit	Totali i Rasteve të trajtuara	Mosha		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Eësdom	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kolegji universitar Bedër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kolegji Universitar Qiriazi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Mesdhetar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Europjan i Tiranës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Drejtësisë, UT	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ligjit në Shkodër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti “Marin Barleti”	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

⁴Universitetet janë të mbyllura në këtë periudhë

1.4 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010


Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundur për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtronë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistike që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

Rastet e trajtuara GUSHT 2021 (Platforma juristionline.al)	
<i>Natyra e çështjeve/lloji i problematikave</i>	
<i>Rastet e lidhura me gjendjen e fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë COVID -19</i>	0
<i>Çështje CIVILE</i>	87
<i>Çështje PENALE</i>	10
<i>Çështje ADMINISTRATIVE</i>	49
<i>Kërkesë për informacione të ndryshme</i>	16
<i>Kërkesë për ndihmë juridike dytësore</i>	0
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA 162	

Numi i rasteve te trajtuara



- çështje civile
- çështje administrative
- çështje penale
- Kërkesë mbi informacione të ndryshme

- Numri i Gjëlber 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjëlber në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. *Si platforma juristonline ashtu edhe linja e gjëlber janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.*

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitim të këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.

Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre thjesht përmes një telefonate, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitim të ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative).


NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjëlber 08001010)
--

TOTALI I RASTEVE 37


1.5 Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas natyrës së çështjes)**




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas kategorisë përfituese)**



Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin GUSHT 2021

475 raste



KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

1. Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, rezulton se nga **37 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **23** prej tyre rezultojnë kërkuese femra dhe **14** prej tyre kërkues meshkuj. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore GUSHT 2021		
<i>Kategoria F/M</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkues Femra	23	
Kërkues Meshkuj	14	
<u>TOTALI = 37 Vendime Gjyqësore</u>		

2. Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, rezulton se nga **37 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, në **29 prej tyre** kërkuesit i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme dhe në **8 vendime** kërkuesit bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore GUSHT 2021		
<i>Kategoria përfituese</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>

Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme		29	
Kategori e veçantë (Total 8)	<i>Viktimë dhune / diskriminimi</i>	5	
	<i>Person me aftësi të kufizuara</i>	3	
	<i>Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale</i>	-	
	<i>Komuniteti Rom</i>	-	
<u>TOTALI = 37 Vendime Gjyqësore</u>			

3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, rezulton se nga **37 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, **14** prej tyre janë kërkesa për ndihmë juridike dytësore, **17** prej tyre janë kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **6** prej tyre janë kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndihma Juridike Dytësore GUSHT 2021		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore	14	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	17	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	6	

TOTALI = 37 Vendime Gjyqësore

4. Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, nga **37 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, rezulton se:

- **Janë pranuar 36 kërkesa** për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore;
- **Eshtë rrëzuar 1 kërkesa** për ndihmë juridike dytësore.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndihma Juridike Dytësore GUSHT 2021		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim/rrëzim pranim pjesërisht</i>
Ndihmë juridike dytësore	14	Pranuar 13 kërkesa për ndihmë juridike dytësore Rrëzuar 1 Kërkesë për ndihmë juridike dytësore
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	17	Pranuar 17 kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	6	Pranuar 6 kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore
<u>TOTALI = 37 Vendime Gjyqësore</u>		

5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, rezulton se nga **37 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, **19** prej tyre janë çështje civile; **10** vendime lidhen me zgjidhje martesë; dhe **8** çështje administrative.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore GUSHT 2021		
<i>Lloji i çështjes</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Çështje civile (<i>pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie</i>)	19	
Zgjidhje martesë	10	
Penale (<i>raste dhune</i>)	-	
Administrative	8	
<u>TOTALI = 37 Vendime Gjyqësore</u>		

6. Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.


Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Gusht 2021, rezulton se nga **37 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **29 prej tyre janë vendime gjyqësore** të dhëna nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe **8 vendime** janë dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, të ndara si më poshtë:

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:


Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore GUSHT 2021

<i>Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike</i>		<i>Numri i vendimeve gjyqësore</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Tiranë	2	
	Durrës	3	
	Elbasan	2	
	Fier	2	
	Gjirokastrë	1	
	Kurbin	1	
	Lezhë	1	
	Lushnje	3	
	Berat	-	
	Pogradec	4	
	Vlorë	-	
	Shkodër	9	
	Dibër	-	
	Përmet	-	
	Mat	1	
Sarandë	-		
Total = 29 Vendime gjyqësore nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore			
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Tiranë	4	
	Korçë	2	
	Shkodër	2	
Total = 8 Vendime gjyqësore			
Gjykata e Apelit	Korçë	-	
	Durrës	-	
Total = 0			
<u>TOTALI =37 Vendime Gjyqësore</u>			

Paraqitja grafike e vendimeve gjyqësore për muajin Gusht 2021, si vijon:



Numri i vendimeve gjyqesore



■ Numri i vendimeve gjyqesore	21	52	63	78	64	74	84	37
-------------------------------	----	----	----	----	----	----	----	----

■ Numri i vendimeve gjyqesore Linear (Numri i vendimeve gjyqesore)

KONKLUZIONE

✚ Sa i përket ndihmës juridike parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin **Gusht 2021**, në total rezultojnë **475 raste** nga të cilat **201 raste janë trajtuar nga Qendrat** e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; **75 raste janë trajtuar nga Organizatat** Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë; **0 raste janë trajtuar nga Klinikat e Ligjit** pranë IAL-ve (për shkak se universitetet janë të mbyllura këtë periudhë); **162 raste janë trajtuar nga Platforma** juristonline.al si dhe **37 raste** janë trajtuar përmes **numrit të gjelbër 08001010**.
- ✓ Nga analiza e këtyre të dhënave, në krahasim me muajin Korrik 2021, konstatohet një përgjysmim i rasteve të trajtuara nga **824 raste** në Korrik në **475 raste** në muajin Gusht (konstatohet një *renie e ndjeshme e numrit të rasteve nga Organizatat duke marrë në konsideratë dhe faktin që në muajin gusht gjykatat nuk operojnë me kapacitete të plota*).
- ✓ Sa i përket organizatave jofotimprurëse të autorizuara, organizatat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara vijnë të mbeten: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe TLAS.
- ✓ Vlen të evidentohet performanca e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në **Gjirokastrë** ndërsa qendrat që ende kanë nevojë për një promovim të shtuar janë Qendra e **Dibrës** dhe **Lushnjes**;
- ✓ Fokus shumë i madh po i kushtohet grupeve dhe kategorive vulnerabël dhe në këtë kuadër, nga analiza e të dhënave të muajit Gusht 2021, konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë kategoritë në pamundësi financiare;
- ✓ Gjithashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar kategorive të veçanta, kategori e cila përbën mbi 33 % të rasteve të trajtuara për këtë muaj.
- ✓ **Vihet re një numër i ulët rastesh kur përfitues kanë qenë të miturit apo personat që i përkasin kategorive rome apo egjiptiane**. Si rrjedhojë, nevojitet një vëmendje e shtuar përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese të dedikuara për këto kategori.
- ✓ Së fundmi, sa i përket mënyrës së raportimit të të dhënave konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrisë së Drejtësisë, **vihet re se disa nga ofruesit vijnë të mos përcjellin të dhënat sipas formatit të kërkuar** (duke mos specifikuar kategoritë e veçanta përfituese të ligjit). Lidhur me këtë problematikë, i bëjmë thirrje ofruesve të respektojnë elementët e përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistruara”.

✚ Ndhurma Juridike Dytësore

- ✓ Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin **Gusht 2021, në total rezultojnë 37 vendime** gjyqësore nga të cilat në **36 vendime janë pranuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe në **1 vendim është rrëzuar** kërkesa për ndihmë juridike dytësore për mos plotësim dokumentacioni/ mospërmbushje të kriterëve të ligjit.
- ✓ **Nga analiza e këtyre të dhënave**, në krahasim me muajin Korrik 2021, **konstatohet një rënie e ndjeshme e kërkesave për ndihmë juridike dytësore**, me një numër prej 47 vendimesh më shumë pak se në muajin Korrik (*për muajin Korrik janë administruar 84 vendime gjyqësore*).
- ✓ **Lidhur me** kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të të cilëve e përbën gjinia femërore. (*23 përfitues femra dhe 14 përfitues meshkuj*).
- ✓ Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile të kryesuara nga çështjet familjare (zgjidhje martesë).
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore**, rezulton se: për muajin Gusht 2021, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**, e pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

SHTOJCË 1

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- GUSHT 2021

Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
Totali i rasteve të raportuara: 1885

Organizatrat jofitimprurëse të autorizuara
Totali i rasteve të raportuara: 1698

Platforma juristonline.al/ Numri i gjelbër
Totali i rasteve të raportuara: 1742

Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve
Totali i rasteve të raportuara: 29

Total Ndhma Juridike Parësore: 5354 raste për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.

Shënim: Për gjashmë mujorin e parë të vitit 2021, është tejkalluar numri vjetor i rasteve të trajtuara për vitin 2020 (4191 raste).

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR-GUSHT 2021

Vendime Gjyqësore me Objekt Ndhmën Juridike						
JANAR – GUSHT 2021						
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Kthim aktesh/pushim cështjeje/cështje në gjykim/moskompetencë/</i>
205	25	55	2	182	3	1
Totali i Vendimeve Gjyqësore = 473						

